



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 22/6 Prot.

Tiranë, më 05.05.2016

V E N D I M

Nr.49, datë 05/05/2016

“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015”

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 14, germa “b”, 32 dhe 33, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 (më poshtë “Rregullores”), si dhe neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pas dërgimit të Projektraportit “Për mbikëqyrjen e përgjithshme mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015”, i nënshkruar nga institucioni i mbikëqyrur dhe mendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme që ka të bëjë me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015, zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike,

VËREJ SE:

Në zbatim të Vendimit nr. 4, datë 12.01.2016, “Për fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015”, filloi mbikëqyrja e përgjithshme në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015, zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike.

Objekti i mbikëqyrjes ishte i përgjithshëm dhe përfshiu të gjitha momentet e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore e udhëzimet e dala në bazë dhe për zbatim të tij, të cilat kanë lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015; respektimin e kërkesave ligjore gjatë procesit të pranimit për pozicionet e punës objekt mbikëqyrje, në të gjitha fazat e tij.

Mbikëqyrja u realizua duke monitoruar proceset që kanë të bëjnë me, **a)** publikimin e dokumenteve që kanë lidhje me procesin e shpalljes së pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND); **b)** shpalljen e kandidatëve të kualifikuar për të

zhvilluar konkurrimin dhe shpalljen e kandidatëve fitues në listën përfundimtare të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes; **c**) fazën e verifikimit paraprak; **d**) vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore; **dh**) fazën e testimit me shkrim; fazën e intervistës së strukturuar me gojë, e aspekte të tjera të zbatimit të ligjit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, grupi i punës ka hartuar projektraportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur, me shkresën nr. 22/4 prot., datë 11.03.2016, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes*”, duke i lënë kohën e mjaftueshme për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi me funksionet e Sekretariatit Teknik, të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes, me shkresën nr. 22/5 prot., datë 27.04.2016, “*Mbi projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes së përgjithshme, dërguar me shkresën nr. 22/4, datë 11.03.2015*”.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse, rezulton se subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord me përmbajtjen e projektraportit dhe nuk ka paraqitur observacione.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për tu shprehur.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe nenet 32, 33, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17 datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme që ka të bëjë me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015, zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA